

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 23.04.2020 solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm “Komisioni”) më 22.04.2020, ka pranuar Kërkesën për Mendim me nr. 03-98/1 pas Informacionit me propozimin për harmonizim me Kornizën e Përkohshme të Komisionit Evropian për masat e ndihmës shtetërore për mbështetjen e ekonomisë gjatë shfaqjes së COVID-19 (në tekstin e mëtejshëm “Informacion”), të dorëzuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni e shqyrtoi informacionin e dorëzuar, i cili parashikon të ofrohen zgjidhje nga Komisioni për harmonizimin e grupit të dytë të masave ekonomike të Qeverisë për ballafaqimin me krizën COVID-19, të miratuar më 31.03.2019, me Kornizën e Përkohshme të Komisionit Evropian për masat e ndihmës shtetërore në mbështetje të ekonomisë gjatë shfaqjes së COVID-19 me nr. C(2020) 1863, të miratuar më 19.03.2020 dhe Korniza e Përkohshme e Ndryshuar C(2020) 2215, e miratuar më 04/03/2020.

Komisioni konsideron se:

- 1. Ligji për Kontroll të Ndhmës Shtetërore është plotësisht në përputhje me nenin 107 të Marrëveshjes për Funkcionimin e Unionit Evropian (MFUE).**
- 2. Neni 107 i MFUE-së është transponuar në nenin 8 paragrafi (1) dhe nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, i cili nen i referohet përjashtimeve nga ndalimi i përgjithshëm i dhënies së ndihmës shtetërore.**
- 3. Korniza e përkohshme e Komisionit Evropian i referohet ndihmës që kompensojnë dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarje të tjera të jashtëzakonshme, si dhe ndihmën që synojnë eliminimin e vështirësive në ekonominë e brendshme.**
- 4. Në Ligjin për Kontroll të Ndhmës Shtetërore, kjo ndihmë rregullohet në nenin 8 (1) b) dhe nenin 8 (2) b).**
- 5. Në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore “Në vlerësimin e formave të ndihmës shtetërore të cilat mund të kenë ndikim në tregtinë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësive Evropiane, në pajtim**

me nenin 69 të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësive Evropiane dhe vendeve anëtare të tyre, në mënyrë përkatëse zbatohen kriteret të cilat dalin nga zbatimi i drejtë i rregullave të ndihmës shtetërore në Unionin Evropian.

6. Për vlerësimin e grupit të dytë të masave ekonomike të Qeverisë për ballafaqimin me krizën e COVID-19, të miratuar më 31.03.2020, është e nevojshme që dhënësi i ndihmës shtetërore të paraqesë njoftimet për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore në formularin e dhënë si Shtojca I, në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për parashtrimin e njoftimit për dhënien e ndihmës shtetërore, si dhe procedurën për mbikëqyrjen e ndihmës ekzistuese shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 142/11), për çdo masë veç e veç.
7. Komisioni do të veprojë në përputhje me kompetencat e tij pas marrjes së njoftimeve dhe në bazë të çdo njoftimi për dhënien e planifikuar të ndihmës shtetërore, do të përgatisë dhe dorëzojë një vendim.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски